



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI KOMISIONERI

Nr. 1524/1 Prot.

Tiranë, më 13.08.2026

### V E N D I M

**Nr. 219, Datë 13.08.2026**

Kmisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32 dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mori në shqyrtim nr. 198 Regj., datë 05.08.2026, paraqitur nga Shoqata Maqedonase “Ilinden”, Tiranë, përfaqësuar nga Kryetari i saj, z. N. Gj., kundër Bashkisë Pustec dhe Këshillit Bashkiak Pustec, me pretendimin për diskriminim, për shkak të *etnisë* dhe *gjuhës*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I:

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues**

Sipas shkresës nr. 1299/2026, datë 05.08.2026, drejtuar z. P.K, Kryetar i Bashkisë Pustec, z. N. D., Kryetar i Këshillit Bashkiak Pustec, dhe anëtarëve të Këshillit Bashkiak Pustec, subjekti ankues, Shoqata Maqedonase “Ilinden”, Tiranë, parashtron sa vijon:

*“Shoqata Maqedonase “Ilinden”, Tiranë është regjistruar më datë 06.02.2009 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Vendimin nr. 2473 dhe me NIPT L91601455V.*

*Misioni i saj është mbrojtja dhe promovimi i identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të pakicës kombëtare maqedonase në Republikën e Shqipërisë.*

*Duke u mbështetur në Ligjin nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në të drejtën e pjesëtarëve të pakicave kombëtare për të përdorur gjuhën e tyre në marrëdhëniet me organet e vetëqeverisjes vendore në zonat ku ata banojnë tradicionalisht,*

*Shoqata Maqedonase “Ilinden”, Tiranë kërkon që faqja zyrtare e Bashkisë Pustec të jetë e aksesueshme edhe në gjuhën maqedonase, krahas gjuhës shqipe.*

*Ky hap do të kontribuonte në respektimin e të drejtave të Minoritetit Kombëtar Maqedonase, në rritjen e transparencës së institucionit dhe në përmirësimin e komunikimit ndërmjet Bashkisë dhe qytetarëve të saj.*

*Duke shpresuar se kërkesa jonë do të shqyrtohet dhe do të merret në konsideratë, ju falënderojmë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin.”*

Kjo shkresë, e ardhur për dijeni pranë Komisionerit nëpërmjet postës elektronike më datë 05.08.2026, u regjistrua pranë Komisionerit me nr. 198 Regj. (Nr. 1524 Prot., datë 05.08.2026), si ankesë për shqyrtim, me pretendimin për diskriminim ndaj Bashkisë Pustec, për shkak të përkatësisë etnike dhe gjuhësore të pjesëtarëve të pakicës kombëtare maqedonase.

Subjekti ankues, nëpërmjet ankesës së paraqitur, i kërkon në thelb Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi mbështetje dhe ndjekje të çështjes, në funksion të garantimit të së drejtës së pakicës kombëtare maqedonase për të pasur akses në informacionin dhe shërbimet e administratës vendore edhe në gjuhën e saj amtare.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, përkatësinë etnike dhe gjuhën, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

Neni 7/1 i LMD-së<sup>1</sup>, parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”*.

Ligji nr. 96/2017 *“Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”*<sup>2</sup>, të ndryshuar, në nenet 14 dhe 15 të tij, njeh të drejtën e personave që u përkasin pakicave kombëtare për të përdorur gjuhën e tyre në marrëdhëniet me organet e vetëqeverisjes vendore, në njësitë ku ata banojnë tradicionalisht ose në numër të konsiderueshëm.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, neni 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga

<sup>1</sup>Shkurtesë për Ligjin *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

<sup>2</sup>Shkurtesë për Ligjin nr. 96/2017 *“Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar.

Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese, përfshirë edhe në raport me të drejtat gjuhësore të pakicave kombëtare.

Pas regjistrimit të ankesës me nr. 198 Regj., datë 05.08.2026, dhe ndërkohë që procedura administrative pranë Komisionerit ishte në fazën e shqyrtimit paraprak, në datën 10.08.2026, nëpërmjet postës elektronike, subjekti ankues, Shoqata Maqedonase “Ilinden”, Tiranë, njoftoi zyrtarisht *se tërhiqet nga ankesa nr. 198 Regj., datë 05.08.2026*, të drejtuar pranë Komisionerit, lidhur me kërkesën për publikimin e faqes zyrtare të Bashkisë Pustec edhe në gjuhën maqedonase.

Në njoftimin e saj, shoqata ankuese ka kërkuar shprehimisht *tërheqjen e kësaj ankese dhe pushimin e procedurës administrative për shqyrtimin e saj*, duke sqaruar se ndodhet në pritje të një përgjigjeje zyrtare nga Bashkia Pustec, brenda afatit ligjor, dhe se, në varësi të kësaj përgjigjeje, rezervon të drejtën për t’iu rikthyer institucionit me një kërkesë të re, nëse do ta gjykojë të nevojshme.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet: “3. *Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.*”

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshuar, parashikohet se: “*Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ*”.

Në nenin 94<sup>3</sup>/1 të ligjit nr. 44/2015” “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshuar, parashikohet se: “*Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë*”.

Procedura administrative konkrete pranë Komisionerit është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, Shoqata Maqedonase “Ilinden” Tiranë, kundër Bashkisë Pustec dhe Këshillit Bashkiak Pustec, me pretendimin për diskriminim për shkak të përkatësisë etnike dhe gjuhësore. Subjekti ankues ka deklaruar, me anë të e-mailit të datës 10.08.2026, se është tërhequr nga ankesa e paraqitur pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa, të paraqitur nga shoqata ankuese në datën 10.08.2026, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës me nr. 198 Regj., datë 05.08.2026, të paraqitur nga Shoqata Maqedonase “Ilinden”, Tiranë, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa

---

<sup>3</sup> “Tërheqja e ankesës”.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, nenin 32 dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës me nr. 198 Regj., datë 05.08.2026, të Shoqatës Maqedonase “Ilinden”, Tiranë, për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa pranë KMD-së.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONER**

**Genta TAFA (BUNGO)**